

ALARM 13

11 MILIONË EURO PËR FLUTURIM NË VEND

1. QYTETARËT DONATORË KRYESOR I PARTIVE!

Të ardhurat e përgjithshme të partive për zgjedhjet në vitin 2014 është përafërsisht 3 milionë euro. Gati se 70% prej tyre janë mjete të mbledhura nga donacione të personave fizik dhe anëtarësime.



TË ARDHURAT E PARTIVE PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE DHE PRESIDENCIALE¹

PARTIA POLITIKE	VMRO-DPMNE	BDI	LSDM	PDSH	GROM	RDK	Partitë tjera	Gjithsej
LLOJET E TË ARDHURAVE								
Donacione nga persona fizik	€985.798	€100.805	€7.224	€1.470	€34.299	€2.146	€49.069	€1.180.811
Donacione nga persona juridik	€13.350	€0	€0	€0	€0	€0	€46.123	€59.473
Lirime nga mediat	€193.857	€14.106	€116.714	€5.454	€14.277	€0	€0	€344.408
Të ardhura nga subjekte tjera (anëtarësime, transfere nga llogaria e rregullt)	€849.327	€162.601	€284.424	€0	€0	€975	€102.704	€1.400.031
GJITHSEJ	€2.042.332	€277.512	€408.362	€6.924	€48.576	€3.121	€197.896	€2.984.723

Lë përshtypje fakti që qytetarët kanë dhuruar më shumë se 1 milion euro për partitë në pushtet. Për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, 448 qytetarë i kanë dhuruar partisë në pushtet VMRO-DPMNE mesatarisht rreth 700 euro, kurse për kampanjën presidenciale 1.927 qytetarë kanë dhuruar mesatarisht rreth 360 euro. Për BDI-në 22 qytetarë kanë donuar mesatarisht nga rreth 5 mijë euro. Për të gjitha partitë tjera qytetarët kanë donuar përafërsisht 100 mijë euro, që është 10 herë më pak nga donacionet për partitë në pushtet.

A është e mundur në kushte të krizës ekonomike, kur një e treta e qytetarëve jetojnë në varfëri, ata të paraqesin donatorët kryesor të partive?



GJITHSEJ HARXHIME GJATË ZGJEDHJEVE

PARTITË

4 MIL. EURO



LLOGARIDHËNIE NGA KSHZ PËR 7 MILION EURO TË SHPENZUARA DO TË PRESIM!!!

2. REKLAMA DHE PROPAGANDA ZGJEDHIN!

Për realizimin e zgjedhjeve partitë kanë deklaruar shpenzime prej rreth 3 milionë dhe 870 mijë euro, prej të cilave 89% ose 3 milion dhe 444 mijë euro janë për reklama dhe propaganda. Prej këtyre shpenzimeve, 75% ose 2 milionë dhe 587 mijë euro janë shpenzime të partive në pushtet.

SHQYRTIM I HARXHIMEVE PËR REKLAMA DHE PROPAGANDA



GJITHË TË TJERËT
25%



VMRO-DPMNE DHE BDI
75%

3. DO TË MBULOHEK MINUSI OSE DO TË FALET?

BORXHET E PARTIVE NGA ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE DHE PRESIDENCIALE

PARTIA POLITIKE	BDI	GROM	VMRO-DPMNE	Partitë tjera	RDK	PDSH	LSDM	Gjithsej
Gjendja e llogarive nga zgjedhjet	-€312.600	-€222.930	-€247.933	-€12.010	-€5.628	-€12.454	-€69.412	-€882.967
Kompensimi që do të fitojnë nga shteti për pjesëmarrje në zgjedhje	€37.475	€15.360	€247.933	€4.090	€4.337	€25.697	€166.349	€501.241
GJENDJA PËRFUNDIMTARE	-€275.125	-€207.570	€0	-€7.920	-€1.291	€13.243	€96.937	

Partitë kanë deklaruar se kanë përfunduar zgjedhjet me saldo negative prej rreth 883 mijë euro. Mbetet e paqartë se si, pasi të pranojnë kompensimin nga shteti, BDI do të mbulon minusin prej 275 mijë euro dhe si GROM do të ballafaqohet me borxhin prej mbi 207 mijë euro.

Habit saktësia me të cilën VMRO-DPMNE ka llogaritur saldon negative, që është deri në denar identike me kompensimin e pritur nga shteti. Për minusin e paraqitur prej 7.224.225 denarë nga zgjedhjet parlamentare, VMRO-DPMNE pret të merr nga shteti po aq, 7.224.225 denarë? Për zgjedhjet presidenciale dhe saldon në minus prej 8.023.650 denarë, VMRO-DPMNE nga shteti pret pikërisht 8.023.650 denarë?

¹ Burim: Raportet e përgjithshme financiare të partive (organizatorë të kampanjave) për zgjedhjet Presidenciale dhe zgjedhjet e Parakohshme parlamentare të v.2014 <http://www.dksk.org.mk/>.